Kronikë

# I vihet tritol marketit në Kamëz, në pronësi të djalit të ish presidentit të klubit të Kamzës! 6 vite më parë i shpërthyen makinën me eksploziv (VIDEO)

*Një sasi tritoli i është vendosur marketit në pronësi të djalit të ish presidentit në klubit të Kamzës, Naim Qarri në rrugën 'Demokracia'. Pronarët e marketit kanë deklaruar se nuk kanë konflikte dhe nuk e dinë se kush mund të jenë autorë të ngjarjes*

Redaksia
8 Mars, 08:30 | **Përditesimi: 8 Mars, 09:34**

**KAMZË-** Një sasi tritoli i është vendosur marketit në pronësi të djalit të ish presidentit në klubit të Kamzës, Naim Qarri në rrugën 'Demokracia'. Shpërthimi me lëndë plasëse ndodhi rreth orës 01:35 ndërsa nuk raportohet për dëme materiale. Marketi ishte në pronësi të Arbi Qarrit të birit të Naim Qarrit ende nuk dihen rrethanat.

Pronarët e marketit kanë deklaruar se nuk kanë konflikte dhe nuk e dinë se kush mund të jenë autorë të ngjarjes. Autori dallohet përmes pamjeve të kamerave të sigurisë, por për shkak të errësirës nuk është i mundur identifikimi.



LEXO EDHE:
**7 Marsi, Veliaj përuron kopshtin e ri 'Zërat magjikë': Krenar për punën e palodhur të mësuesve dhe edukatorëve**

Kujtojmë se Naim Qarri ka qenë pre e shpërthimeve me tritol edhe më herët. Në vitin 2017, ***Qarrit iu vu një sasi eksplozivi*** në mjetin e tij tip 'Hummer'. Makina mori dëme të mëdha materiale por fatmirësisht, aso kohe nuk kishte persona të lënduar.

Ngjarja ndodhi rreth orës 20:30 të mbrëmjes së të hënës në rrugën "Demokracia", në Kamëz. Policia konstatoi se në krahun e pasagjerit, poshtë makinës, ishte aktivizuar një sasi prej rreth 150 gramësh eksploziv. Autorët sipas policisë kanë përdorur një fitil të shkurtër për të realizuar shpërthimin. Qarri rrëfeu momentet e shpërthimit, ndërsa tha se nuk kishte konflikte apo dyshime mbi autorësinë.

Në përditësim...




Arbi dhe Naim Qarri

G.MO/r.k./Shqiptarja.com

TAG: Naim Qarri | kamez | Tirane | lende plasese | tritol

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**A duhet që PD të dalë me një kandidat në zgjedhjet e 14 majit?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera




Tiranë/ U dëmtua nga një mjet pune në një qendër tregtare, ndërron jetë 32-vjeçari
7 Mars, 15:13



Hodhën mjete piroteknike në stadium dhe u futën në fushë gjatë derbit Partizani-Tirana, në hetim 4 të rinj
7 Mars, 14:47



Zhdukja e Vis Martinaj, reagon ish missi: Po keqpërdoret dëshmia ime! Kur u zhduk ishte me një femër tjetër, por emri i saj po fshihet
7 Mars, 11:28



Aksident te '5 Maji' në Tiranë, përplasen 2 makina! 4 të plagosur (VIDEO)
6 Mars, 21:36



Tiranë/ Hidhet shorti i dytë publik te '5 Maji', 125 familje të tjera të prekura nga tërmeti marrin çelësat e shtëpive të reja
6 Mars, 18:25



Makina përplas 70 vjeçarin me biçikletë në rrugën Fushë Krujë-Thumanë! I moshuari plagoset në kokë dhe kraharor, transportohet tek 'Trauma'
6 Mars, 16:56



8 marsi, deputetet vizitojnë gratë e dënuara në burg! Gjonaj: Kemi kërkuar informacion shtesë për Dan Hutrën
6 Mars, 16:29




Fëmija 1 vjeç i infektuar me HIV gjen mbështetje nga shteti italian, prindërit: Gjykata e Romës na dha leje qëndrimi për 2 vjet
6 Mars, 15:21



Mallra me vlerë 13 mijë euro dhe aksesorë floriri të vjedhura, arrestohen 2 persona në Rinas dhe në Portin e Durrësit, 2 të tjerë nën hetim
6 Mars, 15:04



Kompania shqiptaro-ukrainase dhuron 260 pemë për Tiranën, Veliaj: Hapësirë e re kushtuar Ukrainës në Parkun e Liqenit të Farkës
6 Mars, 14:35



FOTOT / Bashkia e Tiranës vijon investimet, rehabiliton shtresat e asfaltit në rrugën 'Eduart Mano'
6 Mars, 14:32



Miliarderi Italian drekon me Ramën në Tiranë: Shqipëria po bëhet një vend shumë modern
6 Mars, 09:50

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje